



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Eduart Zoloshnja: Aritmetika elektorale e kandidatëve të përbashkët të opozitës

2

FOTO/ Kush është 30-vjeçari që vrau për një orë Rolex dhe varëse flori 16-vjeçarin Mariglen Gjona?

3

Qarkulloni me automatik me silenciator në makinë, arrestohet 2 persona! U gjendet dybi e montuar dhe krehër me 21 fishekë

4

VIDEO/ 'Perle' në futbollin e moshave, shënohet gol nga 75 metra

5

Nusja bën për spital vjehrën në Dimal, 61-vjeçarja përfundon tek Trauma! E akuzoi për marrëdhënien me kunatin

Kronikë

Si u gjet qesja e zezë me 4 granata dhe 2 kapsolla detonatore në parkingun e një lokali në Tiranë, ende mister personat që e braktisën

Policia nuk ka mundur ende të identifikoj personat që lanë qesen me katër granata në parkingun e një lokali në zonën e Kombinatit.

Lokali ku u zbuluan granatat

Sokol Dema

11 Tetor, 11:54 | Përditësimi: 11 Tetor, 14:06

Pastrimi i parkingut do të ishte i zakonshëm si i çdo dite tjetër për sanitaren e një lokali në zonën e Yzberishtit në Tiranë. Por, e njëjta gjë nuk ndodhi gjate mesditës së të hënës së 10 tetorit. Gruaja, në afërsi të disa makinave të parkuara gjeti një send të zi në tokë, i cili dukej se kishte të mbështjellura disa objekte në brendësi. E shkujdesur e hapi për të kontrolluar, edhe pse dyshoi se ishin mbeturina për t’i hedhur, të cilat mund t’i kishte lënë ndonjë klient i pa kujdesshëm. Pasi hapi **qesen e zezë** vuri re se në të gjendeshin granata. Në panik, gruaja njoftoi pjesën tjetër të stafit të lokali, të cilët vunë në dijeni edhe pronaren. Brenda pak minutave mbërriti policia, e cila qetësoi pronarët pasi nuk kishte asnjë rrezik të shpërthenin.

Brenda qeses së zezë të mbeturinave u gjetën katër granata dhe dy kapsollë detonatorë, të cilët nuk ishin aktivizuar për të shpërthyer. Dyshimet e para të policisë janë për një tentativë të poseduesve të këtyre armatimeve për t’i hequr qafe. Pranë lokalit, i cili është një ndër më të frekuentuarit në zonë ka lëvizje të herë pas hershme të patrullave të policisë, prania e të cilave mund të ketë ushtruar presion tek autorët për një kontroll të mundshëm, çfarë i ka detyruar ata t’i lënë në parking të lokalit.

Kur kanë kaluar 24 orë nga ngjarja, policia nuk ka mundur ende të identifikoj personat që lanë qesen me granata. Burime bëjnë me dije se kamerat e sigurisë së lokalit nuk kishin fushëpamje deri në vendin ku u gjet qesja. Blutë janë duke qqyrur edhe kamera të tjera të biznesit, për të parë nëse ndonjë person me precedent apo i skeduar, të ketë kaluar përreth perimetrit të lokalit, çka do të lehtësoj punën e tyre për të identifikuar autorët. Paraprakisht, policia përjashton mundësinë e një sulmi ndaj lokalit.

A.M./Shqiptarja.com

TAG:

kombinat

Tirane

granate

kapsolle

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

SONDAZHI I DITËS:

Negociatat Berisha-Alibeaj, a mendoni se PD do garojë me një kandidat të përbashkët në zgjedhjet vendore?

Po

Jo

Nuk e di

REPORT TV

3 minutat e T me Alibeaj

09:00 - 10:00 E HËNË - E PREMTË

20:00 - 22:30

HOROSKOPI